

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“LEKO KOMPANI” SH.P.K.

Sot, më datë 24/03/2022

Muharrem SHKIRA, lindur ne Bicaj, Gramsh, i datëlindjes 02.05.1991, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me ID 035792901 dhe Nr.personal J10502001G

ka përpiluar këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **“LEKO KOMPANI” SH.P.K.**, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare **“LEKO KOMPANI” SH.P.K.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“LEKO KOMPANI” SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

Veprimtari ne fushen e ndërtimit dhe rikonstruksionit te objekteve civile, turistike, shëndetsore, shoqërore, kulturore, tregtare, sportive,kapanone, industriale, vepra kullimi, ujitje, rrugë, kanalizime, punime infrastrukture, ndertime rrugeshe dhe autosrtrdash, asistencë dhe ekspertizë teknike. Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore. Ndertim ura dhe vepra arti deri ne dhjete metra. Ndertime ujesjellesa dhe kanalizime,kanale e impiante vaditese. Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Punime karpentierie druri. Punime karpenterie metalike, etj.

Punime dhe riparime ndertimi. Rikonstuksione. Punime infrastrukture, punime te veshjeve te fasadave, kryerjen e punimeve ne siperfaqet e gjelberta dhe mjediset urbane, ndertimit te ujesjellsave e kanalizimeve te punimeve te asfaltimit, ndertime rrugeshe dhe autosrtrdash. Punime te mirembajtjes se objekteve te ndryshme.



Prodhim material inerte - gure. Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshem. -Prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit e te lendeve te para per ndertim, makineri, pajisje dhe pjese kembimi, etj

Instalimi i impianteve higjenike, elektrike, hidrosanitare, mirembajtja e tyre. Punime bojatisje hidroizolim – akustike –kundra zjarrit.

Tregtim artikuj te ndryshem industriale, lende te para, artikuj hidro-sanitare, hidraulike, elektrike, mobilje, pajisje elektrike e elektronike, etj

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

Durres, Lagjja 15, Rruga "Emporium", Ish Keneta, Zona Kadastrale 8511, Godine me nr. Pasurise 13/255.

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100.000 Leke (njqindmije)lekë dhe përbehet nga 1 (nje) kuote.

Z.Muharrem Shkira është zotërues e 1 kuote, me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000 leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet **për një afat 5 vjecar**, me te drejte riemerimi.. Administatori i Shoqërisë do të jetë **Z. Muharrem Shkira**.



Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKU THEMELUES

Muharrem Shkira

